

## Stellenausschreibung – Ausbildung in Deutschland Shpallje – Arsim dhe aftësim Profesional në Gjermani

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Republikën e Kosovës, Shoqata e Ndërtuesve të Landit të Bavarisë me mbështetje nga Bashkëpunimi Gjerman Ndërkombëtar GmbH/GIZ në Kosovë, kërkojnë kandidatë/e për arsim dhe aftësim profesional në profesionet e mëposhtme, në Bavari, Gjermani:

### Profesionet e ndërtimit mbi tokë, nën tokë dhe meremetimit

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Republikën e Kosovës, Shoqata e Ndërtuesve të Landit të Bavarisë dhe Bashkëpunimi Gjerman Ndërkombëtar GmbH/GIZ, kanë nënshkruar në fillim të vitit 2017 një marrëveshje bashkëpunimi, në bazë të së cilës synohet përmirësimi i mundësive në arsimin dhe aftësimin profesional në fushën e ndërtimit në Kosovë. Në të njëjtën kohë, do t'u ofrohet mundësia disa të rinjve nga Kosova, për të filluar një („arsim dhe aftësim profesional në sistemin dual“) 2-vjeçarë në Gjermani, në fushën e ndërtimit.

### Kush mund të aplikojë?

Kandidatët nga mosha 18 deri 25 vjeç, me njohuri të mira të gjermanishtes, matematikës, fizikës dhe gjeometrisë, janë të përshtatshëm për këtë ofertë për arsim dhe aftësim profesional. Kërkohen 20 nxënës për arsim dhe aftësim profesional në fushën e ndërtimit mbi tokë, nën tokë dhe meremetimit. Programi fillon më 01.09.2017 dhe zgjat deri në korrik të vitit 2019. Me marrëveshje të dyanshme, ekziston mundësia e vazhdimit për një viti shtesë, për t'u çertifikuar me titullin „Geselle“.

### Profili i kërkuar:

- Njohuri të mira të gjuhës gjermane: A2 ose më lartë
- Stil pune i pavarur, saktë dhe i përgjegjshëm
- Aftësi për punë në grup
- Aftësi për punë artizanale / punë me dorë
- Formë e mirë fizike

### Përparësi përzgjedhjeje do të kenë kandidatët me:

- Çertifikatë të gjuhës gjermane, A2 ose më lartë
- Nivelin e mesëm të lartë (shkollë e mesme)
- Njohuri dhe interes për matematikën, fizikën dhe gjeometrinë
- Eksperiencë pune
- Patentë shoferi

### Si të aplikosh?

Aplikimi duhet të jetë **në gjuhën gjermane** dhe pranohet të dorëzohet në format elektronik si dokument PDF, ose të sillet në formë fizike në Zyret e Punësimit.

Lënda/Subjekti i Email-it: **Aplikim për arsim dhe aftësim profesional në fushën e ndërtimit mbi tokë, nën tokë apo meremetimit të ambienteve të brendshme.**

### Ku mund të marr informacione të mëtejshme?

Informacione dhe gjithashtu video filma (për disa profesione edhe në gjuhën angleze) mund të gjenden në faqet e internetit të Agjencisë Federale Gjermane të Punës, në adresën <https://berufenet.arbeitsagentur.de>

Ju lutem dërgoni dokumentet tuaja, duke bashkëngjitur **formularin (mund ta merrni tek zyrat e punësimit ose tek Qendra Gjermane e Informacionit për Migracion, Aftësim Profesional dhe Karrierë/DIMAK në Prishtinë), një CV** (<http://eurpass.cedefop.europa.eu/en/documents/curriculum-vitae/templates-instructions>) dhe një **letër motivimi**, të gjitha në format **PDF** deri më 08.03.2017 në orën 16:00, në adresën e mëposhtme të emailit: [gshm@rks-gov.net](mailto:gshm@rks-gov.net), apo në Zyret e Punesimit.

Aplikanti/aplikantja duhet të ketë bërë një regjistrim si punëkërkues, në një prej 37 zyrave lokale të punësimit, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët/et e përzgjedhur për testim.